



**REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA**  
**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**

Këshilli Prokurorial i Kosovës me qëllim të përmbushjës së obligimit ligjor të paraparë në nenin 16 të Ligjit për Keshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, nxjerr:

### **Rregullore**

**Për përzgjedhjen të Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë**

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kriterët dhe procedurat për rekrutimin dhe emërimin e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (Njësi).

#### **Neni 2** **Shpallja e konkursit**

Me kërkesë të Keshillit Prokurorial të Kosovës, e në pajtim me nenin 14 të Ligjit mbi Keshillin Prokurorial të Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes shpalljes publike të konkursit do të fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë për pozitën e Drejtorit të Njësitit.

Konkursi publik shpallet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorën Nr. 02/2010, për procedurën e Rekrutimit.

### **Neni 3** **Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit**

Drejtori do të ketë këto të detyra dhe përgjegjësi:

1. Është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas të Njësitit dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit dhe iu përgjigjet të gjitha kërkesave të këshillit për informata.
2. Të udhëheqë proces të drejtë, të pa anshëm dhe të barabartë të vlerësimit të performancës së Prokurorëve dhe zyrave të Prokurorive duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të procedurave dhe metodave të përcaktuara me Rregulloret e përpiluara dhe miratuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës;
3. Në përgatitjen e raporteve për Këshillin Prokurorial të Kosovës lidhur me performancën individuale të prokurorëve dhe identifikimin e gjendjes në zyrat e Prokurorive të Kosovës, përgatit rekomandime lidhur me zhvillimin e politikave dhe praktikave më të mira për ngritjen e efikasitetit dhe performancës individuale të prokurorëve dhe zyrave të Prokurorive;
4. Ndërmerr hulumtime në lidhje me sasinë, kualitetin dhe efikasitetin e punës së prokurorive, për përpunimin e të dhënave dhe informatave si dhe përpilimin e raporteve statistikore dhe raporteve tjera;
5. Përgatit për Këshillin Prokurorial të Kosovës raporte mujore, tremujore dhe vjetore, lidhur me vlerësimin e punës së Prokurorëve dhe zyrave të Prokurorive;
6. Planifikon dhe administron me buxhetin e Njësitit si dhe i propozon Këshillit Prokurorial propozim buxhetin për çdo vit kalendarik.
7. Drejtori siguron besueshmërinë dhe fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave me të cilat disponon Njësi;
8. Kryen çdo detyrë tjetër që i cakton Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës apo Këshilli.

### **Neni 4** **Kualifikimet e Drejtorit të Njësitit**

Drejtori i Zyrës së Njësitit duhet të përmbush këto kualifikime:

1. të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;

2. të ketë përgatitje universitare në Drejtësi, Fakulteti Juridik katër vjeçar;
3. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune si prokuror, gjyqtar, avokat apo në një fushë të ngjashme në zbatimin e ligjit apo të administrimit të së drejtës penale; nga të cilat së paku tre (3) vite përvojë në pozitë udhëheqëse;
4. veti të mira ndër personale dhe aftësi të mira për punë ekipore; aftësi për të përballuar punën nën stres dhe shkathtësi lidërshipi;
5. reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
6. njohje të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe njohuri mbi aplikimin e standardeve dhe praktikave më të mira mbi administrimin e Prokurorive;
7. zotërim të gjuhës Shqipe dhe Serbe, me aftësi për të hartuar dokumente ligjore të logjikshme, të qarta dhe të përpikta; dhe
8. të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale, me përjashtim të kundërvajtjes siç përkufizohet me ligj.

#### **Neni 5** **Komisioni përzgjedhës**

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të emërojë një Komision përzgjedhës për menaxhimin, përgatitjen e listës së ngushtë, përcaktimin e orarit të përzgjedhjes, mbajtjen e testeve të përzgjedhjes, intervistimin dhe vlerësimin e rezultateve me propozim të rekomandimit mbi përzgjedhjen listës përfundimtare e cila i dërgohet Këshillit.

Komisioni përzgjedhës do të ketë pesë anëtarë, së bashku me kryesuesin e Komisionit, në këtë përbërje:

1. Dy anëtarë të këshillit prokurorial, ku njëri prej tyre do të jetë Kryesues;
2. Një Prokuror nga zyrat e Prokurorive të Kosovës;
3. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeprokurorit; dhe
4. Menaxheri i Zyrës së Burimeve Njerëzore të Zyrës së Kryeprokurorit



**Neni 6**  
**Përzgjedhja dhe Intervistimi**

Përzgjedhja dhe Intervistimi i kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e drejtorit të Njësitit do të bëhet mbi bazën e dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorës Nr. 02/2010, për procedurën e Rekrutimit.

**Neni 7**  
**Emërimi i Drejtorit**

Këshilli pas shqyrtimit dhe vlerësimit se kandidati i propozuar përmbush kriteret e përcaktuara me këtë rregullore, voton lidhur me emërimin e kandidatit të propozuar. Kandidati i propozuar do të emërohet në pozitën e Drejtorit të Njësitit me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit.

**Neni 8**  
**Procedura e votimit**

Thirrja e mbledhjes së Këshillit dhe procedura e votimit për emërimin e Drejtorit të Njësitit do të përgatitet në pajtim me Rregulloren e Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

**Neni 9**  
**Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë me të cilën është nxjerr.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë 21/07/2011

Kryetari i Këshillit Prokurorial

  
Ismet Kabashi

